



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 19, datë 17. 07. 2009

PËR “PËRFUNDIMIN E PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT TË BANESAVE, TË CILAT KANË MBETUR PA U REGJISTRUAR NË ZYRËN E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PËR LIDHJEN E KONTRATAVE PARA NOTERIT”

Mbështetur në nenin 32, pika (e) të Ligjit 8652 datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”; Ligjin Nr.9232, datë 13.05.2004 “ Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, (i ndryshuar) ; Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.97, datë 03.02.2008 “ Për procedurat e privatizimit të banesave, objekt i ligjit Nr.7652, datë 23.12.1992 “Për Privatizimin e banesave shtetërore” dhe ligjit Nr.9321, datë 25.11.2004 “Për privatizimin e banesave dhe objekteve , të kthyer në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore” pika 1 dhe 14; si edhe të V.K.B nr. 29, datë 29.09.2008 “Për përcaktimin e njësisë përgjegjëse për ndjekjen e procedurave të privatizimit të banesave, objekt i ligjit 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” dhe të ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004, “Për privatizimin e banesave dhe objekteve, të kthyer ne banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore””, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Të përfundohen procedurat e privatizimit të apartamenteve për lidhjen e kontratave të shitblerjes para noterit, për banesat të cilat kanë mbetur pa u regjistruar pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pas plotësimit të dokumentacionit përkatës. (bashkëlidhur lista me 45 emra).
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë së Tiranës ose personi i autorizuar prej tij, për lidhjen e kontratës së privatizimit pas plotësimit të dokumentacionit përkatës.
3. Ngarkohet Drejtoria Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit për përfundimin e procedurave.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Sokol DERVISHAJ

K R Y E T A R